



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

*ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM
KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA
OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL*

RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS

2011

Prishtinë, Prill 2012



FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

I nderuar z. Kryetar, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës



Ky është Raporti Vjetor i Performancës i katërti të cilin ua dorëzoj unë, si Auditor i Përgjithshëm. Ky raport përqendrohet në mënyrën se si unë i kam shfrytëzuar burimet që mi keni besuar. Përveç kësaj, ai përmbledh rezultatet që zyra ime ka arritur gjatë vitit 2011. Gjithashtu, raporti mundëson krahasimin me dy vitet emëparshme buxhetore.

Raporti Vjetor i Performancës është një përgjigje e rëndësishme drejtuar Kuvendit, e cila ofron një bazë që më bën mua llogaridhënës për ushtrimin e mandatit tim për vitin 2011.

Në të njëjtën kohë, raporti duhet të shërbejë si një kontribut në dialogun për buxhetin e vitit 2013.

Gjatë vitit buxhetor 2011 ne finalizuam sezonin e auditimit 2010/11 në gusht dhe filluam sezonin e auditimit 2011/12 në shtator.

Sipas mendimit tim, parë në retrospektivë ne mund të themi se i kemi përdorur mirë parakushtet që Kuvendi na i ka dhënë në formën e burimeve financiare dukshëm më të larta dhe një kufiri më të lartë të stafit krahasuar me tre vitet e kaluara. Cilësia dhe mbulimi i auditimit ashtu si dhe ndikimi i punës tonë po përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme.

Kjo është si rrjedhojë e një fokusimi më të mirë në

rezultate dhe në një qasje konstruktive mes stafit tim auditor dhe atij mbështetës, të cilët rrisin nivelin e tyre të profesionalizmit në një mënyrë të vazhdueshme. Por, i rëndësishëm gjithashtu ka qenë edhe bashkëpunimi ynë me Komisionin e ri për Mbikëqyrje të Financave Publike, i cili, pavarësisht sezonit më të shkurtër se zakonisht, ka analizuar një numër të madh të raporteve, si dhe bashkëpunimi me ekzekutivin në fushën e Menaxhimit të Financave Publike. Një formë e mirë e dialogut me organizatat e audituara i kontribuon gjithashtu këtij procesi inkurajues. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, mirënjohja jonë shkon për kontributet nga parterët tanë ndërkombëtarë për bashkëpunim.

Qasjet e ndryshuara krijojnë mundësi të reja për zyrën time dhe palët tona kryesore të interesit, legjislativin dhe ekzekutivin. Ndryshimet e aprovuara kohëve të fundit në kornizën ligjore për menaxhimin financiar reflekton zotimin për të zhvilluar efektivitetin dhe efikasitetin në ofrimin e shërbimeve tek qytetarët. Vënia e kësaj në praktikë, në një mënyrë transparente, dhe në një mënyrë përgjegjëse është sfidë për të gjithë pjesëmarrësit.

Pavarësia është një parakusht për një auditim të jashtëm publik që funksionon mirë. Një kornizë e re ligjore për Auditorin e Përgjithshëm është tashmë duke u zhvilluar. Një nga prioritetet e mia për vitet në vijim është të garantoj që kjo kornizë të jetë në pajtim me standardet e pranuar ndërkombëtarisht dhe të implementohet siç duhet. Kjo reflektohet në marrëveshjet e arritura me partnerët aktual dhe ata të rinj të cilët do të na ndihmojnë për këtë në të ardhmen e parashikueshme.

Strategjia jonë është që të bëhemi një institucion publik i auditimit të jashtëm, i cili i zbaton plotësisht dhe në mënyrë të qëndrueshme standardet e pranuar ndërkombëtarisht të auditimit në sektorin publik dhe praktikën e mirë Evropiane. Bashkëpunimi konstruktiv dhe një dialog i fortë për buxhetin me palët tona kryesore të interesit është një domosdoshmëri për arritjen e këtyre ambicieve.

Shpresoj që ky raport do të kontribuoj për këtë.

Prishtinë, 30 prill 2012



Auditor i Përgjithshëm

PËRMBAJTJA

FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

1. PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS.....	6
2. TREGUESIT E REZULTATIT.....	8
2.1 Mbulimi me Auditim.....	8
2.2 Cilësia e raporteve tona.....	11
2.3 Ndikimi.....	13
2.4 Vlerësimet e brendshme dhe të jashtme.....	14
3. BURIMET.....	16
3.1 Burimet nga Buxheti i Kosovës.....	16
3.2 Donacioni i pasurisë jashtë përdorimit.....	19
3.3 Burimet tjera buxhetore.....	19
3.4 Burimet Njerëzore	20
4. PARTNERITETI PËR NDRYSHIM.....	24
4.1 Bashkëpunimi Kombëtar.....	24
4.2 Bashkëpunimi Ndërkombëtar.....	25
5. FOKUSI I ARDHSHËM.....	26
6. LLOGARIDHËNIA E ZAP.....	28
SHTOJCA 1: Parathënie e shkurtë për ZAP.....	30
SHTOJCA 2: Organizimi i ZAP për 2011/12.....	32
SHTOJCA 3: Opinioni i auditimit të jashtëm	33

SHKURTIMISHT RRETH ZAP

Misioni jonë është të “kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar të administratës publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në pajtim me standardet e pranura ndërkombëtarisht të auditimit në sektorin publik dhe praktikat e mira Evropiane. Ne do të krijojmë besueshmëri në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesave të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit përmes rritjes së llogaridhënies publike”.

Vizioni ynë është që të ndërtojmë Institucionin Suprem të Auditimit (ISA), Zyrën Kosovare Kombëtare të Auditimit, të zotëruar plotësisht nga kosovarët dhe e konsideruar nga partnerët ndërkombëtarë dhe palët vendore të interesit si një ISA që vepron mirë.

Si veprojmë: me theks të veçantë në Periudhën e Planifikimit Strategjik (5 vite), ne i rrisim shkathtësitë e profesionistëve të angazhuar në një qasje pozitive të orientuar në të mësuarit; përmirësojmë marrëdhëniet e ngushta me palët tona të interesit, partnerët vendor dhe ndërkombëtar; marrim pjesë në komunitetin ndërkombëtar të ISA-ve; dhe ofrojmë siguri të besuar për qytetarët e Kosovës dhe përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në lidhje me shfrytëzimin e ekonomik, efektiv, dhe efikas të burimeve publike.

Ne *jemi* të dedikuar që jo vetëm të ofrojmë informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike, por edhe të ndihmojmë organet tona të audituara që të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit financiar, duke i shtuar kështu vlerë veprimtarive të tyre.

Ne *jemi* të dedikuar që të ndihmojmë në ndërtimin e qeverisjes së mirë në Administratën Publike të Kosovës dhe t'i përgjigjemi pritshmërive.

1. PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS

PIKAT KRYESORE:

Auditime në kohë, me cilësi, dhe relevancë

Sezoni i auditimit 2010/11 ka përfunduar në fund të gushtit 2011. Në total, ne kemi kryer 89 dhe raportuar 87 auditime të ndryshme. Më hollësisht, ne kemi dorëzuar:

- Raportin e Auditimit të Buxhetit të Kosovës (BK);
- 76 auditime të rregullsisë në kuadër të Buxhetit të Kosovës;
- Katër (4) auditime të rregullsisë të Ndërmarrjeve Publike;
- Katër (4) auditime të menaxhimit financiar;
- Një (1) auditim të performancës; dhe
- Një (1) auditim të fondit të donatorit.

Sezoni i auditimit 2011/12 ka filluar në shtator 2011 dhe ne planifikojmë të raportojmë 105 auditime:

- Raportin e Auditimit të BK;
- 86 auditime të rregullsisë në kuadër të BK;
- Dy auditime të bazuara në sistem;
- Katër (4) auditime të performancës;
- Tetë (8) auditime të menaxhimit; dhe
- Katër (4) auditime të fondeve të donatorëve.

Asistimi në zhvillimin e qeverisjes së mirë dhe MFK

- Ne kemi krijuar marrëdhënie të mira me Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) në Kuvend, që përdor raportet e auditimit të ZAP si input për të kërkuar llogari nga zyrtarët e lartë dhe zhvillon forma të bashkëpunimit ndërinstytucional; dhe
- Bazuar në konkluzionet tona të auditimit, ne kemi marrë pjesë në ndryshime të ndryshme duke krijuar një bazë të shëndoshë për qeverisje të mirë, transparencë dhe llogaridhënie.

Llogaridhënia

- Kemi përgatitur Raportin Vjetor të Performancës në kohë dhe e kemi diskutuar në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike, si bazë për të kërkuar llogari nga Auditori i Përgjithshëm për mënyrën se si ai ka menaxhuar zyrën .

Qeverisja e përbashkët dhe modernizimi

- Kemi azhurnuar Strategjinë e Zhvillimit të Përbashkët me qëllim që t'i përgjigjemi nevojave dhe parakushteve të reja dhe të theksojmë pronësinë dhe qëndrueshmërinë; dhe
- Kemi ri-strukturuar zyrën në mënyrë të vazhdueshme për të nxitur profesionalizëm dhe efikasitet, si dhe kemi zhvilluar mjete dhe instrumente të reja që sigurojnë qasje të orientuar në rezultate, fokus, produktivitet dhe kontroll të mirë të menaxhimit.

Gjatë vitit 2011 ne:

- Zvogëluam numrin e auditimeve të kontraktuara nga 23 në vitin 2010 në 18 këtë vit;
- Futëm në përdorim auditime të ndërmjetme në të gjitha auditimet tona me qëllim që të jemi më shumë parandalues dhe që të sigurojmë se rekomandimet tona adresohen siç duhet;
- Azhurnuam Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë dhe jemi ri-organizuar për të siguruar implementimin e tij;
- Azhurnuam manualin tonë të Auditimit të Rregullsisë bazuar në përvojat e fituara gjatë implementimit;
- Futëm në përdorim rishikime të veçanta analitike mbi draft Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) dhe kemi krijuar një regjim për diskutimin e konkluzioneve tona me Ministrinë e Financave me qëllim që të reduktojmë rrezikun për gabime dhe parregullsi;
- Futëm në përdorim auditimin e të gjitha Pasqyrave Financiare nëntë mujore me qëllim dhënien e këshillave për përgatitjen e PVF-ve;
- Këshilloam ministrinë dhe shpenzuesit e tjerë buxhetor në lidhje me menaxhimin e financave publike dhe çështjet e ndërlidhura me të. Ne kemi kontribuar në zhvillimin e qeverisjes së mirë;
- Në mënyrë të suksesshme, përfunduam Projektin e Binjakëzimit në Partneritet me Zyrat e Auditimit të Britanisë së Madhe, Sllovenisë, dhe Holandës. Këta partnerë na ndihmuan të zhvillojmë më tej veprimtarinë tonë duke zbatuar standardet e pranuar ndërkombëtarisht të auditimit dhe praktikën e mirë Evropiane; dhe
- Organizuam një konferencë ku diskutuam për besimin, llogaridhënien, dhe përgjegjshmërinë. Përfaqësues nga Kuvendi, Qeveria, Media dhe Shoqëria Civile paraqitën pikëpamjet e tyre mbi situatën aktuale dhe se si të zhvillohemi më tutje.

Në maj 2011, gjendja jonë u vlerësua nga Zyra Kombëtare Suedeze e Auditimit (ZKSA) në bashkëpunim me USAID, që shërben si bazë për iniciativat e ardhshme për bashkëpunim. Në Raportin e Progresit të BE për vitin 2011, thuhet se praktika e auditimit të jashtëm është në një ecuri të mirë. Në të njëjtën kohë ajo ka nevojë të zhvillohet më tutje pasi shërben si një shtysë për përmirësimin e administratës publike dhe garantimin e llogaridhënies. Përveç kësaj, në raport thuhet se objektiva kryesore për tu arritur deri në vitin 2014 është themelimi i një institucioni të qëndrueshëm që vepron në pajtim me praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe siguron që organet e audituara t'i adresojnë rekomandimet në mënyrë efektive.

2. TREGUESIT E REZULTATIT

Treguesit e rezultatit tonë bazohen mbi Strategjinë tonë për Zhvillim të Përbashkët. Ato janë:

- a) Mbulimi me auditim;
- b) Cilësia
- c) Ndikimi; dhe
- d) Vlerësimet e jashtme.

2.1 MBULIMI ME AUDITIM

Ne e matim mbulimin e auditimit përmes përqindjes së Buxhetit të Kosovës të përfshirë në auditim, numrin e raporteve të finalizuara, dhe opinionet e dhëna të auditimit.

PËRQINDJAE BUXHETIT TË KOSOVËS TË MBULUAR ME AUDITIM

Auditimi statutor i vitit financiar 2010 filloi në shtator 2010. Raportet e auditimit u finalizuan dhe u publikuan në qershor, kurse Raporti Vjetor i Auditimit në gusht 2011.

Tabela 1 paraqet përqindjen e mbulimit të Buxhetit të Kosovës për tre vitet e fundit.

Tabela 1: Mbulimi i Auditimit të BK (%)

Mbulimi	2011	2010	2009
Shpenzimet	87	87	80
Të hyrat	99	99	95

Mbulimi me auditim nuk është një tregues optimal për të krahasuar tre vitet e fundit. Kjo për shkak se përmbajta e përgjithshme e buxhetit pëson ndryshime. Në të njëjtën kohë, ai nuk merr parasysh auditimin e strukturave jashtë buxhetit, që tashmë mbulohen më në detaje dhe me forma të tjera të auditimit.

Më tutje, ai nuk e reflekton qasjen e re të auditimit të futur në përdorim gjatë dy viteve të fundit, përfshirë një auditim të ndërmjetëm. Në fund të secilit vit, çdo organizatë të audituar i dërgohet një memo për auditimin e kryer ku përfshihen këshillat drejtuar krerëve të institucioneve. Një qasje e tillë është parandaluese dhe hap rrugën për një cilësi më të mirë të Pasqyrave Vjetore Financiare, masa më të mira për adresimin e rekomandimeve të dhëna më herët, dhe për forcimin e sistemeve aktuale të menaxhimit financiar.

Gjatë sezoneve të auditimit 2010/11 dhe 2011/12 kjo qasje është përdorur edhe më shumë. Në dhjetor 2010 u dorëzuan 74 memo të auditimit, ndërsa në dhjetor 2011 u dorëzuan 89 të tilla.

NUMRI I RAPORTEVE TË AUDITIMIT

Në fund të sezonit të auditimit 2010/2011 ne raportuam 87 auditime:

- Raportin e auditimit të BK-së;
- 76 raporte të auditimit të rregullsisë në kuadër të BK-së;

- Katër auditime të rregullsisë të Ndërmarrjeve Publike: Kompania rajonale e ujërave “Hidrodrini”, Kompania rajonale e ujërave “Radoniqi”, Kompania rajonale e mbeturinave “Pastrimi”, dhe Radio Televizionin e Kosovës (RTK);
- Katër auditime të menaxhimit financiar: auditimi i menaxhimit në Termokos, KEK, KOST dhe Trepça; (Fondi i Privatizimit);
- Një Auditim të Performancës në lidhje me subvencionet në bujqësi; dhe
- Një auditim të një projekti ndërkombëtar: Programi i qeverisë daneze “Promovimi i punësimit përmes zhvillimit të aftësive dhe biznesit”.

Sezoni i auditimit 2011/12 ka filluar në shtator 2011 dhe ne planifikojmë të raportojmë 105 auditime:

- Raportin e Auditimit të BK;
- 86 auditime të rregullsisë në kuadër të BK;
- Dy auditime të bazuara në sistem: Programi për Investime Publike dhe Efikasiteti në menaxhimin e sistemit të listës së pagave;
- Katër (4) auditime të performancës: Kontrolli në sigurinë e ushqimit; Inspektimi i barnave; Dhënia e kontratave për furnizim; Efikasiteti dhe ekonomiciteti në prokurimin e pajisjeve të TI-së;
- Tetë (8) auditime të menaxhimit: Efikasiteti në menaxhimin e kompanive të ujërave; Procesi i grumbullimit të të hyrave në KEK; Mbikëqyrja e Projekteve për investime kapitale: Ministria e Infrastrukturës; Përcjellja e rekomandimeve të mëparshme të Trepçës; Sistemet e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) në: RTK; Kompaninë e mbeturinave “Deponimi”; Agjencinë Kadastrale të Kosovës; dhe Kompaninë e ujërave “Mitrovica”; dhe
- Katër (4) auditime të fondeve të donatorëve: Programi “Promovimi i punësimit përmes zhvillimit të aftësive dhe biznesit” (DANIDA); Vlerësimi i DANIDA-s për përvojën e fituar në zbatimin e programit në kuadër të regjimit administrativ vendor.; Rindërtimi i sheshit Skënderbeu - Peja (UNHABITAT), dhe Kthimi i qëndrueshëm në qytetin e Prizrenit (Ambasada BM)

Tabela 2, tregon një ngritje të vazhdueshme të numrit të auditiveve të kryera në tre vitet e fundit. Me kalimin e kohës, ne jemi duke reduktuar numrin e auditiveve të kontraktuara. Arsyeja për këtë është se burimet dhe mundësitë tona janë rritur me hapa të matur me qëllim që të mbulojmë të gjithë auditimin statusor. Kufizimet e mëparshme në kapacitete janë duke u zgjidhur në mënyrë graduale. Njëkohësisht, për ne do të jetë gjithmonë e rëndësishme të kontraktujmë disa auditive për të mundësuar krahasime dhe pika referimi për cilësinë.

Tabela 2: Auditimet e kryera

Entitetet e audituara	Sezoni i auditimit 2011/2012	Sezoni i auditimit 2010/2011	Sezoni i auditimit 2009/2010	Sezoni i auditimit 2008/2009
Auditimi i rregullsisë	87	77	64	56
BK	1	1	1	1
Autoritetet shtetërore ¹	25	24	23	17
Komunat	37	37	33	33
(Të kontraktuara) ²	(18)	(23)	(29)	(31) ³
Institucionet e pavarura	24	15	7	5
Jashtë BK-së	0	4	2	1
Auditimi i fondeve të donatorëve	1	1	1	
Auditime të menaxhimit	8	4	2	
Auditime të performancës	4	3	1	
Auditime të sistemeve	2			
Totali	105	89	70	
Verifikime ⁴	18	34		57

Tabela 3: Auditime të kontraktuara tek firmat private

Tabela 3 tregon numrin auditimeve të kryera dhe të kontraktuara jashtë, përfshirë koston e këtyre auditimeve.

	2011/12	2010/11	2009/10	2008/09
Numri i auditimeve	9 ⁵	23	29	31
Numri i firmave të auditimit	1	3	3	2
Kosto	17,100 ⁶	141,528	141,528	148,940

Numri më i ulët i auditimeve të kontraktuara në sezonin 2010/11, krahasuar me sezonin e auditimit 2009/10, por me kosto të njëjtë është për shkak të futjes në përdorim të auditimit të ndërmjetëm tek komunat në fjalë.

Përveç auditimeve statutorë të rregullisë, ne kryejmë gjithashtu lloje tjera të auditimit si auditime të performancës, auditime të menaxhimit, dhe detyra tjera të veçanta të fondeve të donatorëve.

¹ 9 Ministri, Zyra e Presidentit, Administrata e Kuvendit të Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Administrata Tatimore, Dogana, dhe Universiteti I Prishtinës janë të përfshira.

² Numri i auditimeve të komunave të kontraktuara tek firmat private të auditimit. Vlen të theksohet se komunat që kanë buxhet më të madh dhe mbulojnë 2/3 e buxhetit total auditohen nga ZAP.

³ Këto auditime nuk ishin kryer në kohë për të mundësuar që rezultatet të përdroreshin në Raportin Vjetor të Auditimit 2008. Baza për Raportin Vjetor të Auditimit ishte 25 auditime.

⁴ Tek Verifikimet (një rishikim analitik i fokusuar) ne analizojmë shkurtimisht gjendjen e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në një entitet dhe pastaj në një auditim.

⁵ Gjatë sezonit të auditimit 2011/12 janë kontraktuar nëntë auditime të ndërmjetme. Përveç kësaj, aktualisht janë kontraktuar 18 auditime finale.

⁶ Kjo shifër paraqet koston për nëntë auditimet e ndërmjetme. Koston e planifikuara për 18 auditimet finale që do të kryhen janë €76,900.

⁶ Kështu, shuma për sezonin e auditimit 2011/12 është €93,000.

Qasja në këto auditime është ndryshe. Në mënyra të ndryshme, ne vlerësojmë nëse programet ose institucionet qeveritare i shfrytëzojnë burimet e tyre në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive drejt realizimit të synimeve të tyre. Me fjalë tjera, ky auditim i përgjigjet pyetjeve se a po e marrim vlerën për parën e shpenzuar dhe a ekziston mundësia që paratë të mund të shpenzohen më mirë. Ne po përpiqemi t'i gjejmë dhe t'i analizojmë shkaqet e menaxhimit jo të mirë dhe vlerës jo të mirë për para, si dhe të sugjerojmë mënyra për zgjidhjen e tyre. Për ne, këto janë lloje të reja të auditimit. Qasjet në këto auditime kërkojnë shkathësi dhe metoda shtesë të cilat marrin kohë për tu zhvilluar

Gjatë sezonit 2010/11 ne kryem tre auditime të performancës. Ne publikuam vetëm një raport mbi Sistemin e subvencioneve dhe granteve në bujqësi. Dy raportet e tjera nuk u publikuan. Megjithatë, përmbajtja e tyre u diskutua me Ministrin e Financave dhe partnerë të tjerë të interesuar me qëllim zhvillimin e raportimit të bazuar mbi rezultate, përmirësimin e mëtejshëm të menaxhimit të pasurive publike, si dhe dhënien e kontributit në dizajnimin dhe implementimin e auditimeve tona të rregullsisë.

OPINIONET E DHËNA

Opinionet tona të auditimit në auditimet statutorë të rregullsisë bazohen në standardet e aplikueshme, të njohura si SNISA. Opinionet tona të auditimit për vitin 2010 ishin si në vijim:

- 16 opinione të pakualifikuara. Raporti i BK-së përfshihet në këtë grup;
- 35 opinione të pakualifikuara me theksim të çështjes;
- 19 opinione të kualifikuara;
- Tre (3) opinione të kundërta; dhe
- Për tetë (8) komuna, auditorët nuk mundën të japin një opinion mbi pasqyrat financiare të marra si tërësi për shkak të paqartësisë apo kufizimit të fushëveprimit, i cili është thelbësor.

Ne japim një opinion të pakualifikuar kur, në të gjitha aspektet materiale, ne jemi të kënaqur që: a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza dhe politika të pranueshme të kontabilitetit të cilat janë aplikuar në mënyrë konsistente; b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat ligjore dhe rregulloret përkatëse; c) pikëpamja e prezantuar nga pasqyrat financiare është konsistente me njohuritë e Auditorit rreth entitetit të audituar; dhe d) ekziston një shpallje adekuate e të gjitha çështjeve materiale në lidhje me pasqyrat financiare.

Theksimi i çështjes shpjegon një situatë ku auditori mund të konsiderojë se lexuesi nuk do të kuptojë siç duhet pasqyrat financiare po të mos i kushtojë vëmendje çështjeve të pazakonta ose të rëndësishme.

Një Opinion i kualifikuar, apo akoma më keq një Opinion i kundërt, paraqet nivele të ndryshme të problemeve më serioze në lidhje me kërkesat për raportimin financiar.

2.2 CILËSIA E RAPORTEVE TONA

Një nga prioritetet tona strategjike është që të sigurojmë zhvillim të vazhdueshëm të Sistemit tonë për Menaxhimin e Cilësisë (SMC). Ne mundohemi të sigurojmë se auditimi jonë kryhet në mënyrë profesionale: auditimet duhet të jenë gjithëpërfshirëse, me kohë, të dokumentuara, dhe të rishikuara në

mënyrë adekuatë nga personeli i kualifikuar. SMC-ja përmban tre shtresa të ndryshme: a) Kontrolli i cilësisë, b) Monitorimi i cilësisë dhe c) Sigurimi për cilësi.

Kontrolli i cilësisë është kontrolli i përfshirë në linjën e produktivitetit në detyrat individuale të auditimit. Këtu përfshihet rishikimi mbikëqyrës i planeve të auditimit, përdorimi i dokumentacionit standard për regjistrimin e auditimeve, rishikimi mbikëqyrës i letrave të punës së auditimit dhe i draft-raporteve të auditimit etj.

Monitorimi i cilësisë është procesi përmes të cilit Njësia për Cilësinë e Auditimit rishikon auditimet individuale në mënyrë të pavarur. Ky është një rishikim i përbashkët që kryhet përpara finalizimit të auditimit dhe gjatë fazave të planifikimit, ekzekutimit, raportimit, dhe përcjelljes për të siguruar se auditimi bëhet sipas praktikave dhe politikave tona

Për sezonin e auditimit 2010/11, një monitorim i tillë është bërë në katër (4) pilot-auditime dhe në 6 auditime të ndryshme të rregullsisë. Ndërsa, gjatë gjithë fazës së ndërmjetme të auditimit në sezonin 2011/12 ne monitoruam katër (4) pilot-auditime, plus 20 auditime individuale. Më pas, mësimet e nxjerra u përçuan brenda zyrës tonë.

Sigurimi i cilësisë, është një rishikim që ndodh më pas, i cili përfshin një vlerësim të pavarur të jashtëm ose të brendshëm të sistemeve dhe praktikave tona për kontrollin dhe monitorimin e cilësisë. Në maj të vitit 2011, një vlerësim i tillë u bë nga ZKSA në bashkëpunim me USAID. Në vlerësimin e tyre thuhet qartë se ne jemi në rrugën e duhur, por na nevojitet edhe më shumë mbështetje që të mund të zbatojmë plotësisht standardet e pranuar ndërkombëtarisht të auditimit në sektorin publik.

Sistemi jonë i menaxhimit të cilësisë ka sjellë shumë përmirësime thelbësore në cilësinë e auditimeve dhe raporteve të hartuara në drejtim të lexueshmërisë së tyre, qartësisë, dhe pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare të auditimit dhe praktikave të mira evropiane. Pavarësisht këtij progresi, ende mbetet shumë punë për tu bërë që të sjellim cilësinë në nivelin ku ne synojmë. Prandaj, prioriteti ynë aktual është të sigurojmë cilësinë e auditimit të rregullsisë dhe ta përshtatim atë me standardet e pranuar ndërkombëtarisht të auditimit në sektorin publik, të modernizuara, si dhe të mbajmë numrin e auditimit statutor në nivel të ngjashëm me atë të tanishmin.



ZAP Puna e auditorëve në grup

2.3 NDIKIMI

Ndikimin e auditimit e matim përmes statistikave kryesore lidhur me pikëpamjet e anëtareve të komisionit parlamentar rreth raporteve tona, numrit të dëgjimeve publike, dhe numrit dhe përqindjes së rekomandimeve të adresuara.

Gjatë vitit 2011 ne forcuam edhe më tej marrëdhëniet me palën tonë kryesore të interesit, Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP). Së bashku ne zhvilluam planet e punës për të krijuar një bashkëpunim bazuar në mirëbesimin e ndërsjellë për të arritur më shumë llogaridhënie dhe transparencë në sektorin publik.

Prioriteti kryesor gjatë gjithë vitit në takimet me Komisionin ka qenë shqyrtimi i raporteve të auditimit dhe monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit.

Komisioni ka trajtuar 26 raporte individuale të auditimit. Të gjeturat dhe rekomandimet janë diskutuar në takime ku janë ftuar përfaqësuesit e institucioneve të audituara. Gjatë vitit 2011 KMFP ka shqyrtuar gjithashtu Raportin Vjetor të Performancës të ZAP dhe Raportin Vjetor të Auditimit (të dyja këto raporte u miratuan edhe në seancën plenare). Në një Dëgjim Publik me përfaqësues nga ZAP, MF, KRPP, Media, OJQ dhe Shoqëria Civile u diskutuan rekomandimet e dhëna nga Auditori i Përgjithshëm në Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2010. Regjistrimi i pasurive, prokurimi publik dhe kontrolli i brendshëm ishin fushat që u theksuan më shumë dhe u trajtuan me një interesim të veçantë.

Tridhjetë e tre (33) mbledhje të rregullta dhe një Dëgjim Publik u mbajtën gjatë gjithë vitit në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike. Përfaqësues nga ZAP ishin prezent në këto mbledhje duke dhënë kështu kontribut në sqarimin e çdo paqartësie në raportet e auditimit apo edhe duke ofruar këshilla profesionale në shërbim të rritjes së përgjegjësisë dhe menaxhimit sa më të mirë të parasë publike.

Numri dhe përqindja e rekomandimeve të adresuara në vitin 2010

Janë bërë analiza mbi mënyrën se si janë adresuar rekomandimet për vitin 2010. Objekt analize ishin shtatëdhjetenjë (71) subjekte të audituara. Rezultatet e dala nga këto analiza janë prezantuar në tabelën si më poshtë:

Tabela 4: Shkalla e zbatimit të rekomandimeve për vitin 2010

Subjektet e audituara	Rekom. e dhëna. 2010	Rekomand. e adresuara plotësisht		Pjesërisht të zbatuara (në proces)		Të pa adresuara		Të pa verifikuara nga auditimi	
		Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%
Organizatave të nivelit qendror ¹	334	105	32	136	40	59	18	34	10
Organizatave të nivelit lokal ²	275	42	15	50	18	157	57	26	9
Totali	609	147	24	186	31	216	35	60	10

¹ Në kuadër të organizatave të nivelit qendror janë të përfshira: Kuvendi i Kosovës, ZKM, ZPK, Trepça, 18 Ministri si dhe 15 Institucione të pavarura.

² Në kuadër të organizatave të nivelit lokal janë të përfshira: 34 komuna.

Përveç rekomandimeve të mësipërme të dhëna në raportet tona finale, ne gjithashtu kemi dhënë këshilla për përmirësim gjatë procesit të auditimit. Një pjesë e madhe e këshillave të dhëna është adresuar menjëherë duke përmirësuar kështu cilësinë e informacionit në PVF.

Megjithatë, numri i madh i rekomandimeve të pa adresuara në të njëjtën kohë paraqet një shqetësim për ne. Arsyet për këtë ndryshojnë. Në disa raste rekomandimet tona kanë qenë shumë të përgjithësuara dhe/ose jo shumë specifike. Në disa raste ne mendojmë se mungon gatishmëria apo aftësia për të adresuar si duhet mangësitë. Mekanizmat e llogaridhënies nevojiten të përforcohen për të mbështetur përmirësimin e menaxhimit financiar.

2.4 VLERËSIMET E BRENDSHME DHE TË JASHTME

Vlerësimi është një pjesë kryesore për zhvillimin e suksesshëm si mjet për përmirësimin e performancës organizative. Shumica e ISA-ve janë vlerësuar ose nga partnerët për zhvillim apo ndonjë ISA tjetër, ose kanë qenë të përfshira në forma të tjera të vlerësimit vendor.

Në 2011, ZAP është vlerësuar si nga brenda ashtu edhe nga jashtë.

Si pjesë e vlerësimit tonë të brendshëm, ne kemi aplikuar mjete të ndryshme sipas nevojave të ndryshme për vlerësim. Ne kemi përdorur vetëvlerësimin si një mjet për të testuar veten tonë rreth efektivitetit të menaxhimit financiar dhe sistemeve të kontrollit në mbështetjen e objektivave të punës tonë. Këtë e kemi bërë duke përdorur lista të gatshme verifikuese të modelit të KBFP-së. Rezultat i kësaj është Plani i Veprimit i cili adreson disa mangësi të vërejtura.

Përveç kësaj, Auditori ynë i Brendshëm ka vlerësuar disa funksione të veçanta duke kryer një auditim profesional, të pavarur, dhe objektiv. Si rezultat, Auditorit të Përgjithshëm i janë dhënë një numër rekomandimesh për forcimin e proceseve të brendshme.

Për sa i përket vlerësimit të jashtëm të zyrës tonë, ne kemi përdorur metodat e aplikuara ndërkombëtarisht.

Auditimi i jashtëm i PVF-ve tona për 2010 ka rezultuar me një opinion të pakualifikuar. Pavarësisht prej saj, është dhënë një numër i vogël i këshillave, të cilat janë adresuar të gjitha.

Gjatë vitit 2011 veprimet tona janë vlerësuar nga SIGMA, Komisioni Evropian, dhe nga Zyra Kombëtare Suedeze e Auditimit (ZKSA) në bashkëpunim me USAID. Në raportin e Progresit të BE për vitin 2011 thuhet se praktika e auditimit të jashtëm është në një ecuri të mirë. Në të njëjtën kohë, ajo ka nevojë të zhvillohet më tutje pasi shërben si shtytës për përmirësimin e administratës publike dhe sigurimin e llogaridhënies. Përveç kësaj, aty thuhet se objektiva kryesore për tu arritur në 2014 është themelimi i Zyrës si një institucion i qëndrueshëm që e kryen punën e tij në pajtim me praktikatat e mira ndërkombëtare dhe siguron që organet e audituara t'i adresojnë rekomandimet në mënyrë efektive.

Në korrik 2011 ne organizuam konferencën tonë vjetore të tretë. Gjatë një pune në grupe, ne adresuam një numër çështjesh kryesore për suksese në të ardhmen. Ne diskutuam përvojat e fituara nga sezoni i auditimit 2010/11. Bazuar në mësimet e marra, ne identifikuam veprimet që duhet të ndërmerren. Disa nga partnerët tanë dhanë pikëpamjet e tyre mbi sukseset dhe mangësitë tona. Fushat kryesore ku ne

kemi përmirësuar proceset tona janë auditimi i ndërmjetëm, mbulimi me auditim, komunikimi me organet e audituara, dhe ndikimi. Përveç kësaj, ende ekziston nevoja për të përmirësuar cilësinë dhe për të siguruar një ndikim më të madh duke luajtur një rol më shumë aktiv.



Konferenca e tretë Vjetore e ZAP e mbajtur në korrik 2011



Përmblylla e Projektit të Binjakëzimit "Mbështetja e mëtutjeshme për ZAP"

3. BURIMET

3.1 BURIMET NGABUXHETI IKOSOVËS

Buxheti ynë fillestar për 2011 ishte 1,810,000€. Gjatë vitit, buxheti u rrit me 56,000€, ku janë bërë ndryshimet si në vijim:

- Nga kategoria mallra dhe shërbime janë transferuar 22,000€ në kategorinë shpenzime kapitale për blerjen e 10 licencave të reja të softuerit IDEA;
- Për të bashkë-financuar funksionin e Auditorit të Përgjithshëm edhe për dy vite të tjera, nga rezervat e Qeverisë janë ndarë 60,000€. Këto mjete janë transferuar në një fond të ZCN-së; dhe
- Për financim të projektit të autostradës Morinë – Merdarë, nga buxheti i ZAP janë reduktuar 5,802€.

Buxheti final ishte 1,866,000€, një rritje prej 18,8% gjatë 2010, dhe 44,6% më e lartë se dy vitet e mëparshme. Sipas mendimit tim, kjo rritje pasqyron si zbatimin e marrëveshjes së Qeverisë së Kosovës me Bashkimin Evropian (EPAP) ashtu edhe pritshmëritë e larta nga vendorët.

Përveç kësaj, ne kemi gjeneruar një shumë të vogël të të ardhurave bazuar në tarifën mbi auditimin e një projekti të fondit të donatorit. Këto të hyra janë transferuar drejtpërsëdrejti në llogarinë e Buxhetit të Kosovës.

Tabela 5: Buxheti I ZAP (në Euro 000)


Raporti i buxhetit	Buxheti fillestar	Buxheti final	Buxheti i shpenzuar	%
2011				
Buxheti i përgjithshëm	1,810	1,866	1,728	92.6
Pagat dhe mëditjet	1,098	1,098	1,036	64.4
Mallra dhe shërbime	672	648	575	88.7
Shërbimet komunale	40	38	35	92.1
Transferet		60	60	100.0
Investimet kapitale		22	22	100.0
2010				
Buxheti i përgjithshëm	1,359	1,547	1,547	98.5
Pagat dhe mëditjet	797	816	808	99.0
Mallra dhe shërbime	539	715	707	98.9
Shërbimet komunale	23	40	32	81.2
2009				
Buxheti i përgjithshëm	1,107	1,290	1,146	88.9
Pagat dhe mëditjet	523	666	585	87.9
Mallra dhe shërbime	551	591	535	90.5
Shërbimet komunale	33	33	26	79.5

Ne kemi shpenzuar 92,6% të buxhetit final, një rënie të lehtë në krahasim me vitin 2010. Kjo kryesisht ndërlidhet me vonesat në miratim të buxhetit, vonesat në rekrutim të stafit të ri dhe një qasjeje të matshme sa i përket shpenzimit në fund të vitit duke reflektuar situatën e buxhetit të pamjaftueshëm. Përveç kësaj, niveli i provimeve të kaluara (me implikim të drejtpërdrejtë buxhetor) ishte më i ultë se sa ishte planifikuar.

Pagat dhe mëditjet paraqesin zërin kryesor të shpenzimeve (60%) për ne. Në krahasim me vitin 2010 këto shpenzime janë rritur për 28%. Pjesa më e madhe e kësaj ka ndodhur për shkak të rritjes së numrit të të punësuarve nga 114 në 126. Përveç kësaj, këto shpenzime janë rritur edhe për shkak të zhvillimit profesional të stafit auditues përmes skemës së certifikimit dhe numrit më të lartë të Udhëheqësve të Ekipit të nevojshëm kur mbulueshmëria e auditimit rritet.


Shpenzimet për kontraktimet e auditimeve të Komunave janë në rënie e sipër si rezultat i numrit më të vogël të auditimeve të kontraktuara si dhe i konkurrencës mes kompanive të auditimit që ofertojnë për këtë punë

Grafiku 1. Shpenzimi i buxhetit nëpër kategori ekonomike



Grafikët 1 dhe 2 tregojnë përqindjen e buxhetit të shpenzuar në kategoritë e ndryshme në vitin 2011, respektivisht përqindjen e shpenzimeve në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve. Siç mund të shihet nga tabela 5 më lart, përqindja e buxhetit të përdorur për shpenzimet tjera përveç Pagave dhe Mëditjeve është duke rënë në mënyrë të vazhdueshme përkundër kontributit për financimin e Auditorit të Përgjithshëm për një periudhë dy vjeçare. Përveç kësaj, pjesa më e madhe e shpenzimeve që nuk kanë të bëjnë me pagat ndërlidhen me shpenzimet e qirasë (168,000€). Ky është një tregues për shpenzime të matura përfshirë këtu edhe investimet e pakta në teknologji të re. Me kalimin e viteve, do të ishte e rëndësishme që kjo të adresohet për të përmirësuar efektivitetin e auditimit.

Grafiku 2 Shpenzimi i Buxhetit në Kategorinë Mallra dhe Shërbim




Në grafikun 2 shihet se shpenzimet e qirasë dhe ato të kontraktimit të auditimeve përbëjnë mbi gjysmën e shpenzimeve të kësaj kategorie. Derisa shpenzimet e qirasë vazhdojnë të jenë fikse, shpenzimet e kontraktimit të auditimeve kanë shënuar një rënie të dukshme. Këto shpenzime janë zvogëluar për 130%; nga 235,000€ sa janë shpenzuar në vitin 2010, në 102,000€ në vitin 2011. Kjo ka ndodhë për shkak të ngritjes së numrit të auditimeve të kryera nga vet stafi i ZAP.

Gjithashtu, ne kemi kontraktuar një kompani të re e cila ofron shërbime të telefonisë mobile. Qëllimi ishte zvogëlimi i shpenzimeve për 50%. Çmimi më i ultë i kontraktuar për shërbime ka ulur shpenzimet për këto shërbime për 50% gjatë periudhës 6 mujore korrik - dhjetor.

Në këtë rast, ashtu si edhe në rastin e kontraktimit të auditimit të 18 komunave për të gjithë sezonin e auditimit 2011/12, Organi Shqyrtues i Prokurimit vendosi që për shkaqe teknike prokurimi duhej të rivlerësohej, respektivisht të anulohet. Ne i gjetëm zgjidhjet në të dyja rastet, pas disa vonesave, për të përdorur tenderin e njëjtë dhe ekonomikisht më të favorshëm ashtu siç ishte vendosur në proceset e mëparshme.

Grafiku 3 Shpenzimi i buxhetit për kategori sipas viteve



Nga grafiku 3 shihet se shpenzimet e buxhetit janë rritur çdo vit, por nëse i analizojmë veçmas, shihet se kjo rritje ka qenë kryesisht për paga dhe mëditje. Shpenzimet tjera kanë mbetur pothuajse të njëjta.

3.2 DONACIONI I PASURISË JASHTË PËRDORIMIT

Pasuria jonë jashtë përdorimit, për vite të tëra ishte e deponuar në depon e pasurisë në Graçanicë, si dhe në depon e zyrës sonë, duke zënë kështu një pjesë të konsiderueshme të hapësirës.

Cilësia e kësaj pasurie ishte në rënie e sipër për shkak të kushteve të deponimit. Në të njëjtën kohë është bërë identifikimi i një numër institucioneve të cilët do të mund t'i përdornin pasuritë tona të vjetra pas riparimit të tyre apo një investimi të vogël. Si rezultat, ne morëm vendimin që një pjesë të kësaj pasurie, t'ia dhurojmë si donacion shkollës së mesme “Gjin Gazulli” dhe Qendrës Kosovare për Transfuzion të Gjakut gjatë vitit 2011. Për transferin e kësaj pasurie, në mes ZAP dhe institucioneve të lartpërmendura janë nënshkruar edhe Memorandumet e Mirëkuptimit, ku janë specifikuar kushtet dhe sasia e pranimit/dorëzimit.

Pasuria e dhënë si donacion këtyre dy institucioneve kishte një kosto historike prej 27,000€.

Gjatë vitit 2012 janë marrë hapa të mëtutjeshme në këtë drejtim dhe ne nuk kemi më pasuri të pa përdorshme.

3.3 BURIMET TJERA BUXHETORE

Paga e Auditorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Kabinetit është paguar nga Zyra Civile Ndërkombëtare gjatë vitit 2011. Përveç kësaj, ne kemi marrë edhe asistencë nga jashtë, nga Bashkimi Evropian, përmes mekanizmit të Binjakëzimit deri në shtator të vitit 2011 dhe në pjesën tjetër të vitit përmes bashkëpunimit bilateral me ZKA të Suedisë

Tabela 6: Projektet e financuara nga ndërkombëtarët (në €)

Kategoria	2011	2010	2009
Mbështetje për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës (Projekti i Binjakëzimit nga BE-ja)	333,000	484,000	182,000
Mbështetje e mëtutjeshme për ZAP (financuar nga Bashkimi Evropian)			540,000
Bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë	100,000		
Totali	433,000	484,000	697,315

Qëllimi i projektit të binjakëzimit ishte të ndihmonte në ngritjen e kapacitetit të ZAP për të ofruar siguri në lidhje me përdorimin e fondeve publike në Kosovë. Projekti ka funksionuar në kuadër të kornizës së platformës tonë zhvillimore të brendshme. Ky projekt na ka binjakëzuar me zyrat e auditimit të Britanisë së Madhe, Sllovenisë, dhe Holandës. Deri në shtator të vitit 2011, ekspertë nga këto institucione kanë ofruar mbi 70 misione në Kosovë. Këta ekspertë ndërkombëtarë kanë mentoruar shtatë ekipe gjatë procesit të auditimit në 2010/11. Aftësia e auditorëve për të kryer auditimin sipas praktikave të mira të BE-së është

rritur në mënyrë të theksuar përmes këtij mekanizmi. Ekspertët nga zyrat partnere të auditimit gjithashtu na kanë ofruar ndihmë dhe udhëzime për të forcuar funksionet tjera të zyrës sonë: sistemet e BNj-së, zhvillimi i TI-së, ndërtimi i kapaciteteve menaxheriale, si dhe zhvillimin e qasjes sonë të planifikimit strategjik si dhe shkëmbimi i mësimëve të nxjerra në shkrimin e një Ligji të Auditimit të përshtatshëm që i përafrohet standardeve të BE-së.

3.4 BURIMET NJERËZORE

ZAP është zgjeruar në mënyrë të dukshme që nga 2008. Numri i kufirit të stafit në dy vitet e fundit është rritur nga 86 në 124. Organizimi i trajnimeve adekuate, ndarja e përgjegjësi dhe angazhimi i stafit në detyrat audituese janë sfida të vazhdueshme me të cilat po përballet zyra ime.

STAFI

Kapacitetet tona kryesisht janë zgjeruar në fushën e auditimit. Më 31 dhjetor 2011, ne kemi paguar paga për 124 zyrtarë. Përveç Auditorit të Përgjithshëm dhe Ushtruesit të detyrës të Zëvendës Auditorit të Përgjithshëm, stafi tjetër përbëhet nga 2 Asistentë Auditor të Përgjithshëm, 95 auditorë dhe 28 zyrtarë administrativ. Krahas formës së rregullt të kontraktimit, ne angazhojmë edhe kandidatë të tjerë si zëvendësues për stafin në pushim të lehonisë.

Tabela në vijim paraqet numrin e përgjithshëm të personelit në poste me datën 31 dhjetor në tri vitet e kaluara.

Tabela 7 Kategoria e stafit (në poste në fund të vitit)

Kategoria	2011		2010		2009	
	Shifra aktuale	Pozitat	Shifra aktuale	Pozitat	Shifra aktuale	Pozitat
Stafi Auditues	98		86		61	
Stafi Administrativ	28		28		25	
Totali	126¹	124	114	116²	86	106³

Tabela e mësipërme, ilustron numrin e rritur të kuadrit profesional në tri vitet e fundit. Në bazë të marrëveshjes së Planit të Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE) që Qeveria e Kosovës ka me Zyrën Evropiane, parashihet që Zyra ime të shtoj numrin e kuadrit të saj profesional në mënyrë graduale, dhe në fund të vitit 2013, ky numër i auditorëve të arrijë në 120.


¹ Numri i stafit në fund të vitit është 126. Kjo për shkak të rekrutimit të zëvendësuesve që zëvendësojnë stafin që gjendet në pushim të lehonisë. Në fund, ne kemi paguar paga për 124 staf aktiv.

²Kjo rritje është në pajtim me Planin e Veprimit për Partneritet Evropian.

³Financimi i 106 posteve në vend të 90 posteve të aprovuara nga Kuvendi në fund të nëntorit 2009.

Me kalimin e viteve, përqindja e femrave si në kategorinë profesionale ashtu edhe në atë të lartë është rritur. Me 31 dhjetor 2011 44% e stafit ishin femra krahasuar me 18% sa ishin tre vite më parë.

Grafiku 4: Struktura e Gjinisë



95% e stafit janë nga komuniteti Shqiptar, 4% janë nga ai Serb, ndërsa pjesa tjetër është nga komunitetet e tjera në Kosovë. Ne kemi bërë mjaft përpjekje për të rritur numrin e komuniteteve. Megjithatë, deri më tani nuk kemi qenë të suksesshëm në këtë fushë.

REKRUTIMI

Rekrutimet tona bazohen në merita. Ne punojmë me konkurrencë të hapur dhe përdorim teste të shkruara dhe intervista në mënyrë të matur duke siguruar një trajtim të paanshëm të proceseve. Qasja është në pajtim me praktikën e mira evropiane dhe ndjek qëllimet e Ligjit për shërbimin civil. Synimi ynë është që të identifikojmë punonjës inteligjent, të përkushtuar dhe të kualifikuar, të cilët janë në gjendje të zhvillohen dhe të përsosin profesionin e tyre.

Ne kemi ndërmarrë një sërë hapash për të krijuar një mjedis të mirë të punës të fokusuar në krijimin e rezultateve. Punëtorët tonë përfshihen, vlerësohen dhe inkurajohen për të punuar në mënyrë më efektive. Një qasje e tillë çon drejt një stabiliteti dhe produktiviteti më të madh. Efekti i kësaj qasje mund të ilustruhet me interesimin e shprehur nga më shumë se 1100 kandidatë, të cilët përmes konkurseve kanë kërkuar të jenë pjesë e kësaj organizate.

Tabela më poshtë paraqet rekrutimet dhe numrin e personave që kanë dhënë dorëheqje në tri vitet e fundit.

Tabela 8 Rekrutimet dhe dorëheqjet

Kategoritë/Vitet	Rekrutimet			Dorëheqjet		
	2011	2010	2009	2011	2010	2009
Stafi auditues	10	27	11	1	2	5
Stafi Administrativ	5	8	7	3	4	6
Totali	15	35	18	4¹	6	11

¹ Gjatë vitit 2011 ne kishim një total prej 4 dorëheqjesh, një tjetër të punësuar që ka dalë në pension, dhe një zëvendësuesi që i ka mbaruar kontrata

TRAJNIMET DHE ZHVILLIMI

Ne jemi të përkushtuar të rrisim në maksimum efikasitetin dhe të arrijmë një punë të qëndrueshme duke investuar në stafin tonë, në shkathhtësitë dhe aftësitë e tyre e që është qenësore për suksesin tonë. Të gjithë auditorët do të duhej të arrijnë nivelin e auditorëve të certifikuar.

Shumica e auditorëve janë anëtarë të Shoqatës së Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKÇAK), si dhe pjesëtarët e komunitetit serb, në Shoqatën e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Serbisë (SHKAS). Një interesim i shtuar vërehet edhe për skemën e trajnimeve të ACCA¹, ku një numër i vogël i auditorëve tashmë janë anëtarësuar.

Tabela 9 Nivelet/Gradat Profesionale

Kategoria	2011	2010	2009
Auditor i Çertifikuar	24	23	23
Kontabilist i Çertifikuar	27	25	20
Teknik i Kontabilitetit	21	14	10
Auditor në Trajnim	21	21	8
Auditor të Performancës ²	4	3	-
Auditor i Brendshëm	1	1	-
Totali	98	87	61

Gjatë vitit 2011, 31 auditorë kanë ndjekur ligjërata nëpër nivele të ndryshme të programeve të përmendura. Numri i stafit të avancuar në grada profesionale është 13. Është e rëndësishme të theksoj se për qëllime të këtylla stafi im ka përfituar 396 ditë pushimi për përgatitje të provimeve profesionale. Për këtë periudhë janë paraqitur gjithsej 198 provime. Kalueshmëria në të gjitha nivelet ka qenë 31%.

Aktualisht mbi 25% të auditorëve kanë arritur të kalojnë nivelin Auditor i Certifikuar sipas skemës aktuale të certifikimit, gradë të cilën duhet ta arrijnë të gjithë auditorët. 74% e auditorëve tanë kanë kaluar nivelin e parë. Rekrutimi i vazhdueshëm i auditorëve të rinj do të thotë se në një të ardhme të afërt do të kemi një numër të lartë të Auditorëve në trajnim.

Zhvillimi konstant profesional dhe personal i stafit është thelbësor për ofrimin e shërbimeve të cilësisë së lartë klientëve tanë. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional është çështje kyçe. Gjatë vitit 2011 kemi organizuar trajnime për më shumë se 60 tema të ndryshme që ndërlidhen me auditimin. Janë aranzhuar mesatarisht 7000 orë trajnimi, duke përjashtuar trajnimet dhe mentorimet e ekspertëve ndërkombëtarë. Mesatarisht kemi pasur 70 orë trajnimi për person.

¹ ACCA – ACCA – Shoqata e Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar në Angli

² Numri i Auditorëve të Performancës është 14, përfshirë Drejtorët. Tetë prej tyre kanë qenë ose janë të përfshirë në skemën e certifikimit për auditor të rregullsisë. Katër prej tyre nuk kanë marrë pjesë kurrë në skemë të certifikimit. Trajnimi i tanishëm i auditorëve të performancës përcjell një rrugë tjetër zhvillimi.

Përveç kësaj, një nga zyrtarët e mi të lartë ka marrë pjesë në një trajnim të ofruar nga Fondi Evropian për Ballkanin, me temën, “Mbështetja e Ekselencës dhe Udhëheqjes në Qeverisje”. Këtu përfshihet edhe puna për dy muaj në Zyren Federale të Auditimit në Gjermani (BRH).



REGJISTRIMI I KOHËS DHE VLERËSIMI I STAFIT

Sistemi është futur në përdorim në fillim të sezonit të auditimit 2011/12 dhe mundëson regjistrimin e të gjitha aktiviteteve ditore dhe ofron informata të dobishme për planifikim, monitorim, dhe ngritjen e cilësisë. Sistemi ofron një formë shumë praktike të komunikimit në mes të punëtorit me mbikëqyrësin në përmbushjen e rezultateve. Tashmë kemi vlerësuar sistemin në mënyrë që ta avancojmë edhe më tej.

Sistemi i vlerësimit të stafit tashmë është funksionalizuar dhe ofron kontribut të vlefshëm për zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe planifikimin e përbashkët të auditimit. Cilësia e sistemit do të zhvillohet gradualisht duke ndjekur përvojën e pjesëmarrësve nga implementimi dhe adaptimin e plotë të vlerave dhe qasjeve themelore.

4. PARTNERITETI PËR NDRYSHIM

4.1 BASHKËPUNIMI KOMBËTAR

Gjatë viteve të kaluara, ne kemi zhvilluar qasjet tona dhe forcuar bashkëpunimin me entitetet e audituara dhe partnerët tjerë.

Bashkëpunimi me Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike po zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme. Kuptimi në rritje i roleve dhe objektivave të njëri tjetrit ka shërbyer në përmirësimin e llogaridhënies dhe transparencës në fushën e financave publike. Përveç kësaj, janë marrë iniciativa reciproke për të adresuar kornizën ligjore të ZAP. Këto përpjekje tashmë e kanë vendosur këtë çështje në agjendën politike.

Më tutje, bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe lokale tashmë është pjesë e qasjes së integruar. Ne në përgjithësi kemi zhvilluar një qasje të mirë bashkëpunimi me entitetet e audituara, duke u përpjekur kështu për të rritur procese dhe sisteme të qëndrueshme të menaxhimit të financave publike si dhe rritjen e besueshmërisë për sa i përket raportimit.

Një bashkëpunim i mirë është zhvilluar edhe me Ministrinë e Financave sidomos në fushat e zhvillimit të strukturave të qeverisjes dhe praktikave të mira në fushën e MFP-së. Ne tani duhet të theksojmë po ashtu bashkëpunimin me Ministrinë e Integrimeve Evropiane për sa i përket prioriteteve afat-shkurtër dhe afat-mesme për institucionin tonë.

Marrëveshjet e bashkëpunimit me Prokurorinë e Shtetit, Eulex-in dhe Agjencinë Kundër Korrupsionit, kanë konsistuar në sigurimin e ndihmës së ndërsjellë, koordinimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të të dhënave.

Ne i konsiderojmë marrëdhëniet me publikun dhe mediat si shtytës për shtimin e vlerës të përdorimit të parasë publike. Menjëherë pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike, ne kemi zhvilluar udhëzuesin tonë të brendshëm për implementimin e tij. Autoritetit kompetent i është dorëzuar një raport mbi këtë.

Si burim i rëndësishëm informacioni është edhe ueb-faqja jonë zyrtare, ku raportet e auditimit dhe informacioni i publikuar, është i hapur për publikun e gjerë. Vet ekzistenca e kësaj formon bazën për një numër kontaktesh, shkëmbim informatash dhe bashkëpunim.

Gjatë vitit 2011, në mediat vendore janë publikuar rreth 160 artikuj, analiza dhe intervista bazuar në raportet e auditimit apo edhe përgjigjet dhe intervistat e Auditorit të Përgjithshëm.

Më tutje, gjatë vitit ne kemi pasur një bashkëpunim të mirë me Shoqatën për kontabilistë dhe Auditorë, OJQ, firma private të auditimit, ofrues kombëtar të trajnimeve dhe donatorët me qëllimin për të promovuar praktikën e mira të menaxhimit financiar, si dhe për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien.

4.2 BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi ynë nga projekti i binjakëzimit me partnerët tanë nga Zyrat e Auditimit të Britanisë së Madhe, Sllovenisë dhe Holandës përfundoi në shtator 2011. Ky projekt na ka ndihmuar në zhvillimin e aftësive për të kryer auditimet sipas standardeve ndërkombëtare të BE-së. Nga strukturat e përfshira evropiane, ky projekt është vlerësuar si mjaft i suksesshëm.

Për sa i përket bashkëpunimit bilateral, është arritur një marrëveshje midis Zyrës Kombëtare Suedeze të Auditimit dhe zyrës tonë, me qëllim të ofrimit të ndihmës për ndërtimin e kapaciteteve tona në fushën e auditimit të performancës dhe të rregullsisë si dheqeverisjes së përbashkët. Ky projekt fillimisht kishte për qëllim të zgjas deri në vitin 2013 por tani është në proces të ri-përcaktimit dhe do të zgjatet për disa vite më shumë dhe do të fokusohet drejt auditimit të performancës.

Projekti i dytë i binjakëzimit do të filloj në shtator të vitit 2012. Aktualisht, ne jemi në fazën fillestare duke bërë ndryshimet e duhura në raport me ndryshimet e mjedisit të jashtëm dhe strategjisë dalëse të Auditorit të Përgjithshëm.

ZAP ende nuk është anëtare e INTOSAI-it apo partnere në rrjetin e Gjykatës Evropiane të Auditorëve me ISA-të nga vendet kandidatë dhe kandidatë potenciale. E gjithë kjo, ngase Kosova ende nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara. Gjatë vitit 2011, një numër aktivitetesh janë ndërmarrë nga ana jonë dhe partnerëve ndërkombëtarë në hapjen e rrugës për pjesëmarrjen tonë në grupet punuese duke bërë të mundur që auditorët tanë të shkëmbejnë informata dhe të diskutojnë përvojat e fituara kolegjë e tyre nga organizatat simotra. Rezultati i kësaj tashmë është manifestuar dhe ne për herë të parë marrim pjesë në këtë rrjet.

Ne kemi arritur të marrim pjesë në seminare dhe konferenca të tjera të mbajtura në vendet rajonale dhe ato të Evropës por deri në një nivel të caktuar. Mundësia për të ndarë përvojat me kolegjë nga vendet tjera është qenësore për zhvillim të zyrës sime.

Sipas pikëpamjes sime, mënyra jonë e të punuarit është e nevojshme në përpjekjet për ndryshime të qëndrueshme si në zyrën time ashtu edhe tek palët tona të interesit.



Vizitë nga delegacioni i zyrës së Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë (Institucioni Suprem i Auditimit të Shqipërisë)

5.FOKUSI I ARDHSHEM

Strategjia jonë synon vendosjen e një platforme të qëndrueshme e cila do të na mundësojë që në mënyrë konsistente të bëjmë prezantimin e objektivave tona dhe me kohë të themelojmë “një ISA që performon mirë”. Fokusi i strategjisë dalëse i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sigurimi i pronësisë vendore dhe qëndrueshmëria institucionale

- Azhurnimi i kornizës sonë ligjore me qëllim të sigurimit më të mirë të pavarësisë, qartësisë të mandatit dhe harmonizimi me ligjet tjera në fushën e administratës publike. Projektligji duhet të bazohet në parimet e INTOSAI-t (Deklaratën e Limës dhe Meksikës);
- Implementimi dhe azhurnimi i Strategjisë së Zhvillimit të Përbashkët;
- Sigurimi i konsistencës dhe efektivitetit në bashkëpunim me partnerët tanë ndërkombëtarë;
- Implementimi i një kulture të orientuar kah performanca ku ne përmbushim objektivat tona operacionale dhe administrative përmes të punësuarve profesionistë, etik, të motivuar në të gjitha nivelet; dhe
- Zhvillimi dhe forcimi në vazhdimësi i kapaciteteve të brendshme organizative për të përmbushur kërkesat për ndryshim si dhe për të menaxhuar ndryshimin; dhe
- Sigurimi i një akomodimi të qëndrueshëm me zyrë

Kontributi në forcimin e qeverisjes së mirë

- Konsolidimi i cilësisë së Auditimit të Rregullsisë dhe forcimi i Auditimit të Performancës dhe të Menaxhimit;
- Zhvillimi i auditimit tonë të fondeve të donatorëve, bazuar në tarifë, duke hapur rrugën për marrëdhënie të reja financiare në mes të Kosovës dhe komunitetit të donatorëve. Si të tilla ne planifikojmë të kryejmë rreth 3– 4 auditime të fondeve të donatorëve;
- Adresimi i fushave të reja të auditimit dhe futjen në përdorim të një qasje më të fokusuar në sistemin e prokurimit;
- Vazhdimi i hartimit të RVA-së dhe RVP-së me kohë, me cilësi të rritur bazuar mbi një mbulim më të madh të auditimit si dhe të raporteve më relevante dhe të lexueshme;
- Futja në përdorim të qasjeve të reja, forma dhe masa që synojnë të zhvillojnë dhe përmirësojnë qeverisjen e mirë; dhe
- Thellimi i bashkëpunimit dhe komunikimit të jashtëm me shoqërinë civile, mediat dhe projektet.

Zhvillimi dhe ruajtja e cilësisë

- Forcimi i funksionit të cilësisë;
- Numri i auditorëve të licencuar dhe certifikuar do të jetë për 25 më shumë krahas me numrin aktual (rreth 75). 10 auditor të rinj do të rekrutohen gjatë vitit 2012;
- Futja në përdorim e një skeme të azhurnuar për certifikim profesional të auditorëve tanë në pajtim me SNISA- të e modernizuara;

- Futja në përdorim e mjeteve tjera elektronike për auditim; dhe
- Menaxhim dhe mjete më të mira administrative të implementuara duke trasuar rrugën për një auditim më efektiv.

Bashkëpunimi

- Vazhdimi i bashkëpunimit me Zyrën Kombëtare Suedeze të Auditimit përmes një marrëveshjeje afatgjate me fokus zhvillimin e auditimit të performancës në mënyrë të duhur; dhe
- Fillimi i projektit të binjakëzimit në vjeshtën e vitit 2012 duke ndihmuar në mënyrë të gjerë dhe fleksibile në zbatimin e strategjisë përmbyllëse për Auditorin e Përgjithshëm.



6. LLOGARIDHËNIA E ZAP

Sigurimi i integritetit

Përmes kësaj, garantoj se informacioni në Raportin Vjetor të Performancës, përfshirë edhe pasqyrat financiare, janë të sakta, të besueshme, dhe objektive.



Lars Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm

Deklarata e Transparencës

Përmes kësaj, garantoj se puna jonë gjatë vitit 2011 është kryer në pajtim me Statutin e Shërbimit Civil dhe Kodin e mirësjelljes së ZAP-it



Qerkin Morina, Asistent Auditor i Përgjithshëm;



Ibrahim Gjylderen, Asistent Auditor i Përgjithshëm;



Fatmir Uka, Drejtor i Administratës;



Adem Sylejmani, Drejtor i Burimeve Njerëzore

SHTOJCAT

SHTOJCA 1: PARATHËNIE E SHKURTË PËR ZAP

ROLI

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është institucion kushtetues i pavarur dhe i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit. ZAP udhëhiqet nga Auditori i Përgjithshëm, mandati dhe detyrat e të cilit janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrës së Auditimit në Kosovë. Deri në përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare, Auditori i Përgjithshëm do të jetë i emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN).

Auditori i Përgjithshëm aktual u emërua në fillim të vitit 2009 dhe do të ushtrijë funksionin e tij në pajtim me rregulloret në fuqi. Në ushtrimin dhe përmbushjen e detyrimeve të tij për arritjen e objektivave, Auditori i Përgjithshëm gëzon liri të plotë të ndërmarrë aksionet e duhura në funksion të kompetencave të tij. Ai përgjigjet vetëm para Kuvendit.

Ruajtja e objektivitetit dhe pavarësisë tonë nga organizatat të cilat i auditojmë është vendimtare. Objektiviteti dhe pavarësia duhet të sigurohen me zbatimin e mirë të një mandati të gjerë, të qëndrueshëm, dhe ligjor, pajtueshmërinë me standardet profesionale të auditimit; dhe kodin e mirësjelljes profesionale.

AKTIVITETIJONË

Ne kryejmë Auditimet e Rregullsisë të Buxhetit të Kosovës dhe të gjitha organizatave buxhetore në bazë vjetore, ku përfshihen Kuvendi, Zyra e Presidentit, çdo ministri dhe agjenci ekzekutive, komunat, organet e pavarura dhe entitete të tjera.

Ne gjithashtu kryejmë Auditime të Performancës. Kjo është në fushëveprimin tonë, por nuk është një kërkesë vjetore e parashikuar me ligj. Këto auditime do të kryhen në mënyrë që të vlerësojmë nëse programet qeveritare janë duke u menaxhuar si duhet, ekonomikisht, dhe në mënyrë efikase, dhe nëse janë vendosur masa për matjen dhe raportimin e efikasitetit të tyre.

Ne raportojmë për auditimet tona tek entitetet e audituara dhe Kuvendi (KMFP) dhe këto raporte do të publikohen. Raportet tona do të përmbajnë rekomandime ku do të adresohen mangësitë më serioze të identifikuar. Me këtë duam t'i ofrojmë një shërbim auditimi profesional e të integruar Kuvendit, Qeverisë, dhe Taksapaguesve.

Me qëllim që të ndihmojmë në zbatimin, zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e Menaxhimit të Financave Publike, ne do të sigurojmë tatimpaguesit dhe donatorët ndërkombëtar se burimet publike përdoren në mënyrë ekonomike, efektive dhe efikase dhe t'i shtojmë vlerë proceseve përkatëse zhvillimore. Ne do ta bëjmë këtë duke siguruar se fondet publike raportohen, administrohen dhe përdoren në mënyrën e duhur dhe me maturi.

PROCESI I LOGARIDHËNIES

Pasqyrat tona Vjetore Financiare (PVF) përgatiten sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Ato janë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik mbi Bazat e Parasë së Gatshme dhe modifikimet e aplikueshme sipas vendimit të Qeverisë. Për të na mundësuar të dëshmojmë përgjegjshmërinë dhe objektivitetin tonë, Kuvendi çdo vit duhet të emërojë një auditor të jashtëm për të bërë auditimin e Pasqyrave tona Vjetore Financiare.

Opinionet e auditimit mbi PVF-të e viteve 2008, 2009 dhe 2010 nuk u përfshinë në Raportin Vjetor të Performancës të vitit të kaluar. Këto auditime janë raportuar në Kuvend dhe për të gjitha u dhanë opinione të pa kualifikuara ('i pastër'). Raportet janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të ZAP¹.

Përpos Auditimeve të Jashtme, edhe auditimet e brendshme të kryera nga njësi për auditim të brendshëm sigurojnë që Zyra vepron në pajtueshmëri me ligjet dhe politikat e veta.

KUSH DO T'I VLERËSOJË METODOLOGJITË TONA TË AUDITIMIT?

ZAP ka bërë shumë për të siguruar që të ndiqen praktikrat dhe metodologjitë e mira të auditimit. Ne jemi duke zbatuar një kornizë të menaxhimit të cilësisë. Metodologjitë e mira dhe korniza e cilësisë sigurojnë që auditimet tona kryhen në pajtim me standardet² e themeluara të praktikës profesionale.

ZAP ndjek sistemin e rregullt ndërkombëtar të kontrolleve mbi punën e saj të auditimit; auditimet tona ekzistojnë në kuadër të një kornize rigoroze të standardeve të auditimit, të cilin stafi mëson se si ta përdorë gjatë programit tonë të trajnimit. Pastaj, gjatë një procesi qartësimi, diskutohet me entitetet e audituara për të gjeturat e auditimit. Në sistemin tonë është ndërtuar rishikimi nga ana e menaxhmentit dhe monitorimi i mëtejshëm bëhet nga një funksion i veçantë në kuadër të Zyrës. Pas kësaj, raportet tona publikohen dhe janë të hapura për ekzaminim. Pastaj fillojnë shqyrtimet dhe diskutimet në Kuvend së bashku me Ekzekutivin rreth rekomandimeve të auditimit..

KUSH DO TË RISHIKOJË FINANCIMIN TONË?


Si Auditor i Përgjithshëm, unë – përveç këtij Raporti Vjetor të Performancës që fokusohet në mënyrën se si është shpenzuar buxheti i Zyrës së Auditimit – do të përgatis dhe dorëzoj çdo vit në Kuvend kërkesat buxhetore. KMFP dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa mund të më drejtohen mua për të shpjeguar kërkesën buxhetore për Zyrën dhe për të diskutuar raportin tonë mbi planet dhe prioritetet, objektivat e performancës, raportin tonë vjetor të performancës, dhe praktikrat tona të menaxhimit.

Qeveria e inkorporon kërkesën time buxhetore në Buxhetin e Kosovës të paraqitur në Kuvend ashtu siç është e propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Buxheti i Zyrës do të aprovohet nga Kuvendi. Praktikisht, proceset aktuale nuk janë të dizajnuara mirë dhe praktikrat lejnë vend për përmirësim.

¹ www.oag-rks.org

² SNISA, Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit përcaktojnë parakushtet themelore për funksionimin e duhur dhe sjelljen profesionale të institucioneve të tilla: www.issai.org

SHTOJCA 2: ORGANIZIMI I ZAPPËR 2011/12



PAKSH

PJDS

Qev. Lokale

Performance

Qev. Qendore

NP & PRIV


Infrastruktura

Sistemet e Prok.

Inst. e Pavar.

- Departamenti i auditimit për Punë, Arsim, Kulturë dhe Shëndetësi
- Departamenti i auditimit për Punë të Jashtme, Drejtësi dhe Siguri
- Departamenti i auditimit për Qeverisje Lokale
- Departamenti për auditim të Performancës
- Departamenti i auditimit për Qeverisje Qendrore
- Departamenti i auditimit për Ndërmarrje Publike dhe Privatizim
- Departamenti i auditimit për Infrastruktura
- Departamenti për auditim të rregullsisë dhe performancës për sisteme të prokurimit
- Departamenti për auditim të Institucioneve të Pavarura

SHTOJCA 3: OPINIONI I AUDITIMIT TË JASHTËM

	
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM KANCELARIA GJENERALNOB REVIZORA / OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL	
DATA PËRANUAR / DORËZUAR	10.08.112
Shifra e klasifikimit	Nr. Fajl.
10	483

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Raporti i Auditorit të pavarur dhe Pasqyrat Financiare
për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011

Përmbajtja	
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	3-4
1. Të përgjithshme.....	5
2. Bazat e përgatitjes së Pasqyrave financiare dhe konventat e kontabilitetit.....	5
2.1. Bazat e përgatitjes	5
2.2. Konventa e kontabilitetit	5
2.3. Valuta raportuese	5
2.4. Prokurimi.....	5
2.5. Zotimet	6
2.6. Data e autorizimit.....	6
2.7. Buxhetet	6
Pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor 2011	7

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Auditorin e Përgjithshëm

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, të Republikës së Kosovës (më tej referuar si "Organizata" ose "ZAP"), që përfshinë Pasqyrën Pranimit të Ardhurave dhe Pagesave, Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2011, si dhe një përmbledhje të politikave kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Menxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menxhmenti është përgjegjës për përpilimin dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave financiare në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligjin Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të cilët përcaktojnë që pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik - Raportimi Financiar sipas Bazës së Kontabilitetit me Para të Gatshme. Kjo përgjegjësi përfshin: dizajnimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e kontrolleve të brendshme që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të cilat nuk përmbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; duke zgjedhur dhe zbatuar politika përkatëse të kontabilitetit; dhe duke bërë vlerësime kontabël që janë të arsyeshme në rrethanat përkatëse.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion për pasqyrat financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike si dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të arritur siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale. Auditimi përfshinë përmbushjen e procedurave për të fituar dëshmi të auditimit për shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga vlerësimet e auditorit, përfshirë vlerësimet e rrezikut të gabimeve materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në arritjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori merr parasysh kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të përcaktoj procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne i kemi përdorur janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.

Deloitte.

Opinion

Sipas opinionit tonë, Pasqyra e Pranimit të Parave dhe Pagesave dhe Raporti i Ekzekutimit të Buxhetit paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2011, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik – Raportimi Financiar sipas Bazës së Kontabilitetit me Para të Gatshme.

Çështje tjera

Pasqyrat financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitet që kanë përfunduar me 31 dhjetor 2010 dhe 2009 janë audituar nga auditorë të tjerë, të cilët kanë shprehur një opinion të pakualifikuar mbi këto pasqyra financiare me datë 2 qershor 2011 dhe 23 shtator 2010.

Deloitte Kosovo Sh.p.k.

Prishtinë, Kosovë
9 gusht 2012

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Shënime për Pasqyrat Financiare për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2011

1. Të përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është themeluar në vitin 2003 nën Rregulloren e UNMIK-ut 2002/18, të datës 4 tetor 2002. Pas pavarësisë mandati dhe roli i Auditorit Gjeneral është specifikuar në Kushtetutë¹. Rregullorja e UNMIK-ut u shfuqizua me Ligjin nr. 03/L-075 mbi Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të datës 05 qershor 2008.

Sipas Kushtetutës (Neni 138), Auditori i Përgjithshëm (AP) duhet që në baza vjetore të raportojë për rezultatet e auditimit (Raporti Vjetor i Auditimit dhe raportet për detyra të veçanta) dhe aktivitetet e tij personale (Raporti Vjetor i Performancës)

2. Bazat e përgatitjes së Pasqyrave financiare dhe konventat e kontabilitetit

2.1. Bazat e përgatitjes

Sipas Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë Nr. 03/L-048 dhe Ligji Nr. 03/L-221 për Ndryshim dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048, AP duhet që të përgatit dhe paraqes Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) në përputhshmëri me kërkesat financiare dhe raportuese të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik ("SNKSP") në përputhje me bazën e kontabilitetit me para të gatshme. Për më shumë, këto pasqyra financiare përfshijnë shpalosjet të kërkuara nëpërmjet Rregullores Financiare Nr. 07/2011 për Pasqyrat Financiare Vjetore të Organizatave Buxhetore.

Këto politika janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha vitet e paraqitura, nëse nuk është shprehur ndryshe. Kërkesat shtesë janë zhvilluar gjatë viteve.

2.2. Konventa e kontabilitetit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazën e kontabilitetit me para të gatshme. Sipas këtyre parimeve:

- a. Të hyrat njihen kur ato pranohen. Ato alokohen nga fondet në dispozicion në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës (BKK), sipas së cilës fondet e alokuara duhet të shpenzohen në kuadër të ndarjeve të tilla të njohura si "fondet e alokuara" për atë ndarje; dhe
- b. Shpenzimet njihen kur paguhen nga llogaria bankare e BKK.
- c. Pasuritë jo monetare janë prezantuar për qëllime të shpalosjeve. Kostoja historike e këtyre pasurive paraqet koston e blerjes dhe çdo shpenzim shtesë i lidhur drejtpërsëdrejti me blerjen e këtyre pasurive.

2.3. Valuta raportuese

Librat dhe shënimet e ZAP-it mbahen në Euro, valuta ligjore në territorin e Republikës së Kosovës.

2.4. Prokurimi

Marrëveshjet kontraktuese për blerje apo marrje me qira të mallrave ose shërbimeve, duke përfshirë shërbimet profesionale, nënshkruhen, në emër të ZAP-it, vetëm nga zyrtarët e autorizuar. Aktivitetet për blerje apo marrje me qira, përveç nënshkrimit të kontratës, përfshijnë thirrjen për tenderë, kuotime apo propozime me furnitorë të mundshëm mbi bazën e specifikimeve të detajuara siç përcaktohet në Ligjin nr. 03/L-241 dhe Ligjin nr. 04/L-042 mbi Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

¹ Neni 136, 137, 138 dhe 157

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Shënime për Pasqyrat Financiare për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2011

2. Bazat e përgatitjes së Pasqyrave financiare dhe konventat e kontabilitetit (vazhdim)

2.5. Zotimet

Zotimet, ashtu siç janë shpalosur në pasqyrat financiare, regjistrohen kur urdhërohet ndonjë blerje që ka të bëjë me vitin aktual buxhetor, edhe pse mallrat dhe shërbimet në të vërtetë janë pranuar/dhënë, dhe detyrimi është shkaktuar në buxhetin e vitit të ardhshëm.

2.6. Data e autorizimit

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2011, janë autorizuar për lëshim nga ana e z. Lage Olofsson, auditori i përgjithshëm dhe znj. Luljeta Osmani, zyrtare kryesore e buxhetit dhe financave me 31 janar 2012.

2.7. Buxhetet

Buxheti final është i përfshirë në Sistemin Informatik të Menaxhimit Financiar të Kosovës dhe gjithashtu është publikuar si pjesë e pasqyrave financiare të konsoliduara të Qeverisë së Kosovës.

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM


**Pasqyrat financiare për vitin që ka përfunduar më 31 dhjetor
2011**

Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave të Parave të Gatshme

		2011	2010	2009
		Llogaria e Vetme e Thesarit	Llogaria e Vetme e Thesarit	Llogaria e Vetme e Thesarit
		BKK	BKK	BKK
	Shënim	Euro '000	Euro '000	Euro '000
PRANIMET				
Ndarjet nga Fondi i Përgjithshëm	1	1,728	1,547	1,146
Totali i Pranimeve		1,728	1,547	1,146
Pagesat				
Operacionet				
Pagat dhe Mëditjet	2	1,037	808	585
Mallrat dhe Shërbimet	3	575	707	535
Shërbimet Publike	4	34	32	26
		1,646	1,547	1,146
Transferet dhe Subvencionet	5	60	-	-
Shpenzimet Kapitale	6	22	-	-
Totali i Pagesave		1,728	1,547	1,146



Lage Olofsson
Auditor i Përgjithshëm



Luljeta Osmani
Zyrtar Kryesor Financiar

Pasqyra e Realizimit të Buxhetit

Pasqyra e konsoliduar e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2011.

	Shënim	2011				2010	2009
		Buxheti fillestar	Buxheti Final	Aktuali	Varianca	Realizimi	Realizimi
		A	B	C	D = C - B	E	F
		Euro '000		Euro '000		Euro '000	
Daljet e parasë së gatshme nga llogaritë e thesarit							
Pagat dhe mëditjet	7	1,098	1,098	1,037	(61)	808	585
Mallrat dhe Shërbimet	8	672	648	575	(73)	707	535
Shërbimet publike		40	38	34	(4)	32	26
Transferet dhe Subvencionet		-	60	60	-	-	-
Shpenzimet kapitale		-	22	22	-	-	-
Totali i pagesave i bërë nga BKK nëpërmjet të LIVTh		1,810	1,866	1,728	(138)	1,547	1,146

Të përgjithshme

Auditori i përgjithshëm është caktuar nga PCN-ja për një periudhë pesë vjeqare. Viti 2011-të është viti i tretë i tij në detyrë. Auditori i përgjithshëm është përgjegjës për funksionimin e ZAP-it dhe cakton strategjinë zhvilluese të Zyrës. Strategjia e Përbashkët Zhvillimore (SPZH) e ZAP-it definon misionin e ZAP-it si dhe pasqyron një vizion të qartë për këtë periudhë.

Objekti i misionit strategjik të ZAP-it është bazuar në auditimin e duhur të cilësisë së sektorit publik, duke kontribuar në ndërtimin e një menaxhimi të shëndoshë financiar në administratën publike të karakterizuar nga përgjegjësitë e forta menaxheriale për përdorimin transparent të burimeve publike dhe rezultatet e arritura nga politikat. Auditori i Përgjithshëm synon të ndërtojë Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës, plotësisht funksionale dhe e gatshme të marrë vendin e saj në mesin e Institucioneve të Larta të Auditimit të Evropës. Një organizatë e tillë do të udhëhiqet plotësisht nga shtetasit e Kosovës dhe do të jetë plotësisht e qëndrueshme. Acquis Communautaire dhe PVPE 2008 sigurojnë themele të forta mbi të cilat janë të bazuara ky mision dhe vizion.

Baza ligjore është e mbështetur në Kushtetutë, Ligji mbi ZAP-in si dhe kornizën e përgjithshme ligjore lidhur me menaxhimin dhe administrimin e financave publike.

Pasqyrat Vjetore Financiare të vitit 2012 janë përgatitur në përputhje me SNKSP- Parimet e bazuara në parandë e gatshme si dhe Rregullës Financiare Nr. 07/2011 për Pasqyrat Financiare Vjetore të Organizatave Buxhetore.

Shënim 1

Ndarjet e fondit të përgjithshëm

Klasifikimi ekonomik	Shënim	2011	2010	2009
		BKK Euro '000	BKK Euro '000	BKK Euro '000
Pagat dhe mëditjet	2	1,037	808	585
Mallrat dhe Shërbimet	3	575	707	535
Shërbimet Publike	4	34	32	26
Subvencionet dhe transferet	5	60	-	-
Shpenzimet kapitale	6	22	-	-
Totali		1,728	1,547	1,146

Shënim 2

Pagat dhe mëditjet

Përshkrimi	Shënim	2011	2010	2009
		BKK Euro '000	BKK Euro '000	BKK Euro '000
Neto pagat		876	687	498
Tatimi mbi të hyrat personale		63	44	31
Pagesa e kontributit pensional nga punëdhënësi		49	38	28
Pagesa e kontributit pensional nga i punësuari		49	38	28
Pagesat për Sindikata -0.10% deri te 0.50%		-	1	-
Totali	2.1	1,037	808	585

2.1 Nga kjo shumë e përgjithshme, 67% përbëjnë koeficientet, 18% shtesat (rrezikshmëria, udhëheqësit e ekipeve), 10% shtesat për shujta dhe 5% shtesa të parapara me Ligjin për shërbyesit civil.

Shënim 3**Mallrat dhe shërbimet**

Përshkrimi	Shënim	2011	2010	2009
		BKK	BKK	BKK
Pagesat nga BK		Euro '000	Euro '000	Euro '000
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit	3.1	24	9	1
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit		12	17	14
Internet		3	2	1
Shpenzimet tjera telefonike	3.2	16	23	18
Shpenzimet postare		-	-	-
Shërbimet e anëtarësimit dhe trajnimit	3.3	32	25	16
Shërb e ndr. intelektuale këshillëdhënëse	3.4	102	235	118
Shërb kontraktuale tjera	3.5	18	11	17
Shërbime teknike		1	6	1
Shpenzimet për anëtarësim		2	-	-
Mobiljet dhe pajisjet (nën 1000€)		10	17	22
Telefona (nën1000€)		10	10	1
Kompjuterë (nën1000€)		27	30	18
Harduer për TI(nën1000€)		1	1	2
Makina fotokopjuese(nën1000€)		-	-	5
Pajisje tjera (nën1000€)		5	20	17
Furnizime për zyrë		20	22	21
Furnizime ushqim dhe pije	3.6	4	1	2
Furnizime pastrimi		5	2	4
Furnizime veshmbathje		1	-	10
Akomodimi		-	6	-
Vaj për ngrohje	3.7	16	11	2
Derivate për gjenerator		2	1	1
Karburant për vetura		7	8	8
Regjistrimi i automjeteve		1	-	7
Sigurimi i automjeteve		6	6	-
Taksa komunale		-	1	-
Sigurimi i ndërtesave dhe tjera		13	15	14
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve		4	4	6
Mirëmbajtja e ndërtesave		14	14	10
Mirëmbajtja e tekn.informative		6	15	8
Mirëmb.e mobileve dhe pajisjeve		1	-	1
Qiraja për ndërtesa		168	168	168
Qiraja-përdorime tjera (TIK dhe SRK)	3.8	15	-	-
Reklammat dhe konkurset		3	2	-
Shërbime shtypje -jo marketing	3.9	10	1	-
Botimet e publikimeve	3.10	-	8	10
Informimi publik		9	9	10
Drekat zyrtare	3.11	7	4	2
Totali		575	707	535

3.1 Kjo shifër paraqet shumën e shpenzuar për udhëtime brenda vendit për auditim të komunave.

3.2 Ne kemi nënshkruar kontratë me kompaninë "Dardafone" në korrik të vitit 2011. Çmimi më i ultë për shërbime ka ulur shpenzimet për 30 % gjatë vitit.

3.3 Kjo shifër paraqet shumën e paguar për trajnim dhe certifikim të auditorëve të ZAP-it nga SHKÇAK-u dhe paraqet një pasqyrim të një numri më të madh të auditorëve.

3.4 Kjo shifër paraqet shumën e paguar tri kompanive të auditimit për auditimin e PVF 2010 për 23 komuna, si dhe për kontraktim të një kompanie për auditim të ndërmjetëm të PF 9 mujore të 9 Komunave për 2011.

Shënim 3

Mallrat dhe shërbimet (vazhdim)

3.5 Kjo shifër paraqet shumën e shpenzuar për përkthimin e raporteve të auditimit dhe Raportit Vjetor të Auditimit për shkak se ishte e pamundur që këto të kryhen me kapacitetet vetanake të ZAP-it.

3.6 Pjesa më e madhe e kësaj shume paraqet shpenzimet për gostinë e fundvitit për 130 anëtarë të stafit dhe mysafirët.

3.7 Sistemi i ngrohjes në objektin e ri kërkon furnizim me naftë. Shpenzimet për gaz për ngrohje në objektin e vjetër kanë qenë më të ulta.

3.8 Kjo shifër paraqet pagesat për fotokopjet e marra me qira si dhe për sistemin e regjistrimit të kohës.

3.9 Kjo shifër paraqet shumën e paguar për shtypjen e Raportit Vjetor të Performancës 2010 dhe Raportin Vjetor të Auditimit 2010 të ZAP-it. Në vitin 2009 dhe 2010 kodi i përdorur për shpenzime ka qenë Publikimet.

3.10 Referoju shënimin 3.9

3.11 Pjesa më e madhe e kësaj shume paraqet a) shpenzimet për konferencën vjetore të ZAP-it (kostoja e përgjithshme për këtë ngjarje ka qenë rreth 8,000 Euro). Nga kjo shumë, 66 % është paguar nga Projekti i Binjakëzimit dhe 34% është paguar nga buxheti i ZAP-it, dhe b) kostoja për pritjen e një delegacioni nga ISA e Shqipërisë.

Shënim 4

Shërbimet komunale

Përshkrimi	Shënim	2011	2010	2009
		BKK	BKK	BKK
		Euro '000	Euro '000	Euro '000
Rryma		16	13	10
Uji		2	1	-
Mbeturinat		1	2	2
PTK-fikse		15	16	14
Totali		34	32	26

Shënim 5

Subvencione dhe transfere

Përshkrimi	Shënim	2011	2010	2009
		BKK	BKK	BKK
		Euro '000	Euro '000	Euro '000
Kontributi në paga	5.1	60	-	-
Totali		60	-	-

5.1 Duke u bazuar në Vendimin Nr. 09/26, të datës 27 korrik 2011, shuma prej 60,000 Euro është alokuar nga Qeveria e Kosovës për të financuar funksionin e Auditorit të Përgjithshëm. Kjo shumë është paguar në avans në një fond të administruar nga ZNC-ja.

Shënim 6
Shpenzimet Kapitale

Përshkrimi	Shënim	2011	2010	2009
		BKK Euro '000	BKK Euro '000	BKK Euro '000
Licenca për softuer	6.1	22	-	-
Totali		22	-	-

6.1 Shuma prej 22,000 Euro është paguar për blerjen e 10 licencave të reja për softuerin IDEA, një mjet për mostrim.

Shënim 7
Paga dhe Mëditje

Arsyeja për dallimet ndërmjet buxhetit dhe realizimit janë vonesat në miratimin e buxhetit për vitin 2011 gjë e cila ka rezultuar në vonesa në procesin e rekrutimit. Përveç kësaj, niveli i provimeve të kaluara në SHKÇAK (me implikime direkte buxhetore) ishte më i ultë se që kishim pritur. Si dhe, për shkak të situatës së përgjithshme buxhetore, ne nuk kemi angazhuar zëvendësime siç bëjmë zakonisht.

Shënim 8
Mallra dhe Shërbime

Arsyeja për dallimet ndërmjet buxhetit dhe rezultatit është qasja e shpenzimit të matur si rezultat i situatës së përgjithshme buxhetore.

Shpalosja e detyrimeve (Neni 15)

Detyrimet kontingjente

Përshkrimi	Shënim	2011	2010	2009
		BKK Euro '000	BKK Euro '000	BKK Euro '000
Qiraja	15.1	10	10	-
Totali		10	10	-

15.1 Shuma e prezantuar është një llogaritje e kompensimit eventual për riparime të ish-zyrës sonë që mund të kërkohen nga pronari.

Shpalosja e pasurive (neni 16)

16. a) Përmbledhje e pasurive jo-financiare (me vlerë mbi 1000 Euro) në posedim të organizatës buxhetore

Përshkrimi	Shënim	2011	2010	2009
		BKK Euro '000	BKK Euro '000	BKK in Euro 000'
Veturat		45	68	102
Pajisje të TI		34	13	65
Pajisje tjera		11	25	46
Totali	16a.1	90	106	213

16. a) Përmbledhje e pasurive jo-financiare (me vlerë mbi 1000 Euro) në posedim të organizatës buxhetore (vazhdim)

16a.1 Nga kjo shumë, 22,000 Euro paraqesin blerje të reja gjatë vitit 2011 (Licencat e IDEA-së), 38,000 Euro paraqesin vlerën e zhvlerësimit në vitin 2011.

16. b) Përmbledhje e pasurive jo-financiare (me vlere nën 1000 Euro) në posedim të organizatës buxhetore

Përshkrimi	Shënim	2011	2010	2009
		vlera historike Euro '000	vlera historike Euro '000	vlera historike Euro '000
Pasuria nën 1000 €		343	319	270
Totali	16b.1	343	319	270

16b.1 Kjo shifër përfshinë kompjuterë, shrederë, mobilje. Gjatë vitit 2011 ZAP ka blerë pajisje nën 1000 Euro në shumë prej 50,707 Euro. Përveç kësaj, pasuria e çregjistruar që paraqet një vlerë historike prej 27,000 Euro, i është dhënë donacion shkollës së mesme "Gjin Gazulli" (MM Nr. 386) dhe Qendrës Kosovare për Transfuzion të Gjakut (MM Nr. 568).

**16.c). Përmbledhje e stoqeve në fund të periudhës
Klasifikimi i pasurive**

Klasifikimi i pasurive Përshkrimi	Shënim	2011	2010	2009
		Euro '000	Euro '000	Euro '000
Material zyrtar		7	-	-
Derivate për ngrohjen qendrore		9	-	-
Totali		16	-	-

Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit

Përshtatjet e Autorizuara nga LMFP

Kategoria e ndarjes	Shënim	Ndarja Fillestare Buxhetore	Ndryshimi sipas nenit 30, Ligji nr.03/L-048	Ndryshimi sipas nenit 29, Ligji nr. 03/L-048/Buxheti Final	Ndryshimi në të hyrat vetanake	Ndarjet finale të buxhetit SIMFK	Ndryshimet e buxhetit fillestar
		Euro '000 a	Euro '000 b	Euro '000 c	Euro '000 e	Euro '000 f	Euro '000 (f-a)/f
Hyrjet							
Granti qeveritar		1,810	1,810	1,866	-	1,866	3.0%
Të hyrat vetanake	18.1	-	-	-	3	-	0.0%
		1,810	1,810	1,866	3	1,866	3.0%
Daljet (buxheti)							
Pagat dhe mëditjet		1,098	1,098	1,098	-	1,098	0.0%
Mallrat dhe shërbimet	18.2	672	650	648	-	648	-3.7%
Shërbimet publike	18.2	40	40	38	-	38	-5.3%
Transferet dhe subvencionet		-	-	60	-	60	0.0%
Shpenzimet Kapitale	18.3	-	22	22	-	22	0.0%
Fondi i privatizimit		-	-	-	-	-	0.0%
Totali		1,810	1,810	1,866	-	1,866	3.0%

Shënime:

18.1 Shuma e paraqitur tregon tarifën për auditimin e PVF-2010 të projektit Danida. Kjo shumë është arkëtuar në llogarinë kryesore të Thesarit.

18.2 Me vendimin e Qeverisë nr. 22/53, për nevoja të financimit të Autostradës Morinë - Merdar, buxheti i ZAP-it është zvogëluar në kategorinë mallra dhe shërbime në shumë prej 1,709 Euro si dhe në kategorinë shërbime publike në shumë prej 2,046 Euro.

18.3 Bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 11/43 shuma prej 22,000 Euro është transferuar nga kategoria Mallra dhe Shërbime te shpenzimet Kapitale, për blerjen e 10 licencave të softuerit "IDEA".

Numri i punëtorëve (Neni 19)

Departamenti	Numri i punëtorëve në Ligjin e buxhetit 04/L-001	Aktual i punëtorëve në fillim të vitit 2011	Numri Aktual i punëtorëve në fund të vitit 2011
TOTAL	124	117	126*
Departamenti i Auditorëve	97	91	98
Departamenti i Administratës	23	23	24
Departamenti i TIK-ut	4	3	4

Shënim:

Auditori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i kabinetit të Auditorit të Përgjithshëm nuk janë të përfshirë në kufirin për stafin, për faktin se pagat e tyre paguhen nga ZNC-ja. Numri i të punësuarve në listat e pagave është 126. Prej tyre dy punëtorë janë në pushim me pagesë. Dy punëtorë gjenden në pushim pa pagesë, ndërsa njëra pozitë është vakante. OAG ka rekrutuar tri zëvendësime për të siguruar aktivitetin në kuadër të kufirit të përgjithshëm buxhetor për Paga dhe Mëditje. Marrë në përgjithësi, kjo do të thotë se deri në fund të vitit janë paguar paga për 124 punëtorë aktiv.